



VENDIM

Nr. 69, Datë 27.05.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2016 PËR KOMPANINE OST SH.A.**

Ne mbështetje të nenit 16; nenit 20, gërmat “a” dhe “e”; neni 60, pika 4 dhe 5; nenit 110, pika 2 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009; “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr. 62, datë 15.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “OST”sha, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “OST”sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI